

K O N T R A T E  
PER THEMELIMIN E SHOQERISE TREGTARE  
“PINDERI“ Sh.p.k



1. Murat Pinderi, i biri i Hazizit i dt.lindjes 1963, lindur Korçe dhe banues ne bllokun nr.1 Erseke.

2. Gezim Nuredini i biri i Mazllemit, i dt.lindjes 1951, lindur dhe banues ne bllokun nr.1 Erseke.

Madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet kane vendosur te krijojne nje shoqeri tregtare , me pergjegjesi te kufizuar konform vullnetit te tyre te lire dhe ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 “ Per shoqerite tregtare” , ligjit nr.7667 date 28.1.1993 “ Per rregjistrin tregtar “ si dhe ligjeve te tjera ne fuqi si me poshte :

Neni 1

Te themelojne nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar veprimtari tregtare ,te emertuar “ Pinderi” Sh.p.k. Kjo shoqeri tregtare do te kete seline ne rrugen “Bllokun nr.1 Ersekse” , do te zhvilloje veprimtari tregtare per nje periudhe 20- vjecare me te drejte ripertesitje.

Neni 2

Sipas legjislacionit shqiptar shoqeria tregtare “Pinderi” Sh.p.k eshte person juridik shqiptar dhe aktivitetin e saj e rregullon ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjit 7667 date 28.1.1993, si dhe normat e parashikuara ne kete kontrate dhe statut qe i bashkengjitet kesaj kontrate. Shoqeria i pergjigjet marredhenieve me te tretet vetem me fondet e veta dhe pergjigjet per detyrimin e kesaj shoqerie.

Neni 3

**OBJEKTI i shoqerise “ Pinderi ”Sh.p.k. do te jete :**

Grumbullim dhe tregtim bime mjekesore medicinale, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, konfeksione, materiale elektrike, shfrytezim pyjes, permiresime pyjore, pyllezime, rruge pyjore, meremetime e ndertime vepra uji ne kullota, luftim semundje e demtuesish ne pyje, sistemime malore, me shumice e pakice , eksport import brenda dhe jashte vendit.

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 650 000 leke., kapital fillestar i ortakeve te shoqerise “Pinderi “ Sh.p.k ( makine Ifa sipas kontrates se blerjes).

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kapitalin e derdhur nga ortaket e shoqerise “Pinderi “ Sh.p.k . Murat Pinderi dhe Gezim Nuredini, i cili perfaqeson te gjithë kapitalin per blerjen e nje makine Ifa. sipas kontrates blerjes.

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqerine tregtare do te shenohet dhe kapitali i derdhur nga te dy ortaket. Rritja e kapitalit nga ortaket nuk eshte e kufizuar.

Neni 6

Shoqeria vazhdon veprimtarine e saj ne baze te regjistrimit si person juridik ne Gjykatën e rrethit Tirane si dhe rregjistrimin e saj po ne kete gjykate ne rregjistrin tregtar.



Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortaket. Fitimi i realizuar nga veprimtaria tregtare e shoqerise pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet eshte plotesisht i transferueshem per tu perdorur nga ortaket ose per tu depozituar ne nje nga bankat shqiptare.

Neni 7

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asamblea e ortakeve.

Administratori i shoqerise.

Modalitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen nga statuti i shoqerise.

Neni 8

Administratori i shoqerise "Pinderi" Sh.p.k., eshte Murat Pinderi i cili pergjegjet per pasojat e demshme e te shkeljeve ndaj ligjit per shoqerite tregtare.

Neni 9

Vlefshmeria e kontrates:

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe 20- vjecare me te drejte riprertitjeje.

Ortaket vendosin ne cdo kohe mbylljen ose zgjatjen e afatit.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarreveshjeve do te behet konform normave per rregullimin e mosmarreveshjeve ne shoqeri tregtare ne gjykatën e rrethit Tirane.

Neni 11

Dispozitat me te detajuara per shoqerine tregtare "Pinderi" sh.p.k. jane te percaktuara dhe permbahen ne statutin e saj.

Neni 12

Problemet qe nuk jane trajtuar ne aktin e themelimit apo ne statutin e shoqerise dhe qe do te dalin gjate aktivitetit te shoqerise do te zgjidhen mbi bazen e dispozitave te Kodit Tregtar dhe atij civil te Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Kjo kontrate formulohet ne kater kopje nga te cilat njera depozitohet ne zyren e noterise ne Tirane, njera ne gjykatën e rrethit Tirane, njera ne zyren e tatimeve dhe nje kopje mbahet ne dokumentet e shoqerise.

Kjo kontrate eshte e vlefshme qe nga momenti i nenshkrimtit te saj nga ortaket e shoqerise.

ORTAKET  
Murat Pinderi

*Murat Pinderi*

Gezim Nuredini

*Gezim Nuredini*



## STATUT I SHOQERISE TREGTARE "PINDERI" SH.P.K.

Shoqeria tregtare "Pinderi" Sh.p.k. eshte krijuar sipas kontrates per themelimin e saj nga ortakët Murat Pinderi dhe Gezim Nuredini.

**Per te** bere te mundur veprimtarine ekonomike dhe organizimin e kesaj shoqerie ne perputhje me ligjin nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar", eshte perpiluar ky statut me kerkesat e ligjes per shioqerite tregtare me pergjegjesi te kufizuar si me poshte :

### KREU I PARE

#### DISPOZITA TE PERGJITHSHME ( forma, emertimi,objekti,selia ,kohezgjatja)

##### Neni 1

Ortakët e lartepemendur , kane krijuar nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar "Pinderi" Sh.p.k.

Shoqeria tregtare e ka ftuar te drejten e personit juridik me rregjistrimin e saj ne gjykaten e rrethit Tirane si dhe regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar te kesaj gjykate.

##### Neni 2

Emertimi i shoqerise tregtare eshte "Pinderi " sh.p.k. dhe ka si objekt te saj: Grumbullim dhe tregtim bime mjekesore medicinale, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, konfeksione, materiale elektrike, shfrytezim pyjes, permiresime pyjore, pyllzime, rruge pyjore, meremetime e ndertime vepra uji ne kullota, luftim semundje e demtuesish ne pyje, sistemime malore, me shumice e pakice , eksport import brenda dhe jashte vendit.

Selia e shoqerise tregtare "Pinderi" Sh.p.k. eshte ne Bllokun nr.1 Erseke.

Kohezgjatja e shoqerise tregtare eshte parashikuar per nje periudhe 20-vjecare me te drejte riperteritjeje.

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare eshte 650 000 leke( sipas kontrates se shitblerjes te nje makine Ifa).

##### Neni 3

Kapitali themeltar eshte derdhur nga ortakët e kesaj shoqerie, sipas kontrates se shitblerjes. , ne masen 50 % sejcili.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj. Zmadhimi ose zveglimi i ketij kapitali vendoset nga ortakët. Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen tek te tretet vetem pas miratimit te Administratorit

### KREU DYTE

#### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI

##### Neni 4

Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e ortakeve.

Asamblea e ortakeve vendos per ceshtje te tilla si emertimin ose shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive, ndarjen e fitimit, ndryshimet ne statut, zvogelimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise apo likuidimin e saj, shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne nje nga format e kerkuara nga ligji etj.

Neni 5

Asamblea e Ortakeve mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda 4 muajve nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

Neni 6

Shoqeria administrohet nga administratori Murat Pinderi. Ne marredhenie me te trete administratori i ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise.

Neni 7

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar nga administratori i shoqerise dhe e miratuar ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve dhe mund te emerohet per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje.

Shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ne punen e tij gje qe e ben te pamundur kryerjen e detyres.

Neni 8

Per punonjesit qe do te punesohen ne shoqerine tregtare do te zbatohen aktet ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim duke lidhur kontratat e punes me secilin per nje afat jo me shume se periudha nje vjecare. Paga e punes nuk eshte e kufizuar por ajo nuk mund te jete me e ulet se ajo e percaktuar me vendime te vecante te Qeverise.

**KREU I TRETE**  
**MARREDHENIET EKONOMIKE - FINANCIARE**

Neni 9

Viti financiar fillon me daten 1 janar dhe mbaron me daten 31 dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asamblea e ortakeve. Miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarine vjetore te shoqerise behet brenda muajit mars te vitit pasardhes.

Neni 10

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimit Asamblea e Ortakeve percakton pjesen qe i takon ortakut te vetem si dhe te jene zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Fitimi neto i realizuar nga veprimtaria e shoqerise ka te drejte ta perdorin ortakët sipas nevojave te tij dhe ne interes te shoqerise.

Neni 11

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne leke ose dhe ne valute te huaj. Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe mbeshtetet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne pergjegjesi ligjore per punen e tyre.

Neni 12

Shoqeria tregtare me qellim qe te beje sa me te lehte dhe me te shpejte pagesat me te tretet do te hapi nje llogari bankare ne nje nga bankat e shtetit shqiptar. Shoqeria do te kete vulen e saj me emrin e shoqerise.

**KREU I KATERT**  
**ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUIDIMI**

Neni 13

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontraten e themelimit, zgjatja e tij behet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "Pinderi" Sh.p.k.

Ajo prishet kur mbaron afati i percaktimit dhe kur ortaket nuk bien dakord qe te bejne riprteritjen e ketij afati. Shoqeria mund te shnderrohet ne nje nga format e percaktuara nga ligji dhe ne formen e kerkuar nga ligji.

Neni 14

Shoqeria tregtare, hyri ne procesin e likuidimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi, Asambleja e ortakeve te shoqerise "Pinderi" Sh.p.k. emerone nje likuidues, i cili paraqet raportin e likuidimit, gjendjen e aktivitetit dhe nevojshe per perfundimin e tyre. Ne fund te procesit te likuidimit asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar, mbi aktin dhe rregullsine e likuidimit, mbi mbylljen e procesit te likuidimit te shoqerise.

Neni 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe do te lindin gjate ekzekutimit te ketij statuti dhe kontrates se themelimit gjate egzistences se shoqerise si gjate kryerjes se veprimtarise ashtu dhe ne procesin e likuidimit do ti drejtohen per gjykim gjykates se rrethit Tirane.

Neni 16

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zgjidhet sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise si dhe ligjit "Per shoqerite tregtare nr.7638 date 19.11.1992.

Neni 17

Ortaket e shoqerise "Pinderi" Sh.p.k. kane te drejte te bejne ndryshime dhe depozitim vendimesh per sa i perket shtimit te ortakeve, dhe objektit te veprimtarise.

Neni 18

Shoqeria "Pinderi" Sh.p.k. ka te drejte te hapi dege te tjera ne qytetin e Durrësit, Gjirokastrës dhe Korçës dhe te kete perfaqesuesit e saj per ushtrimin e aktivitetit tregtar sipas rregullave dhe ligjeve ne fuqi.

Neni 19

Ky statut eshte hartuar ne kater kopje ku njera kopje depozitohet ne zyren e noterise Tirane, nje kopje ne gjykatën e rrethit tirane, nje kopje ne zyren e tatimeve dhe nje kopje mbahet ne dokumentet e krijimit te shoqerise.

ORTAKET  
Murat Pinderi  
Gezim Nuredini

